



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Stilistikë e gjuhës ruse

Ngarkesa: 4 kredite; 40orë mësimore; 20 leksione / 20seminare

Viti / Semestri : Viti III , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Përkthim-interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë do të zhvillojë kompetencat gjuhësore dhe ligjërimore të studentëve për një komunikim sa më efektiv, si në formën e shkruar dhe në të folur, në sfera të ndryshme të përdorimit. Studimi i lëndës gjithashtu është hartuar:

- Të përmirësojë komunikimin me gojë e me shkrim në gjuhën ruse;
- Të zhvillojë instinktin gjuhësor;
- Të përfshijë aftësitë e dallimit të parimeve të drejtshkrimit, në eliminimin e disa mangësive të caktuara në përgatitjen e studentëve në gjuhën ruse.
- Të njohë sistemin e stileve të gjuhës letrare moderne ruse dhe organizimin e saj infrastrukturor;
- Të zhvillojë aftësitë njohëse;
- Të zgjerojë horizontin dhe të rrisë kulturën e përgjithshme të studentëve;
- Të zbatojë praktikisht njohuritë e fituara teorike në procesin e komunikimit ndërkulturor;

Objektivat specifike lëndore:

- Të njohë karakteristikat stilistike të njësive gjuhësore, varianteve, mënyrave sinonimike të shprehjes dhe ligjeve të përdorimit të tyre në përputhje me kushtet dhe qëllimet e komunikimit.
- Të paraqes themelet teorike të stilistikës si një disiplinë e veçantë shkencore me natyrë gjuhësore të përgjithshme;
- Të njohë studentët me konceptin e stilit funksional, për të dhënë një ide të diferencimit stilistik të gjuhës letrare bashkëkohore ruse;